



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë
Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Nr.135/6Prot.

Tiranë, më 17 / 06 / 2016

V E N D I M

Nr. 63 Datë 17/06/ 2016

P Ë R

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE TIRANË,
“MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË EKONOMIKO-
FINANCIARE”.

ISSH, në zbatim edhe të rekomandimeve të lëna nga KLSH, të lidhura me domosdoshmërinë e ndërhyrjeve ligjore në skemën e sigurimeve, kryesisht në formulën e pensionit; minimizimin e evazionin fiskal; mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensione; skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare; sistemin e pensioneve pasi dega e pensioneve reflektonte deficit i cili kalonte mbi 1% të PBB, si dhe 55% e kontributeve rurale financoheshin nga buxheti i shtetit; stimulimin e pjesëmarrjes në skemën e kontributeve të personave të vetëpunësuar në bujqësi, ristrukturimin dhe reduktimit e deficitit financiar të degës së pensioneve që vinte nga masa e lartë e subvencioneve kontributive që paguante buxheti i shtetit për të vetëpunësuarin në bujqësi; në lidhje me uljen e normativës ligjore të fondit rezervë të sigurimeve shoqërore, etj., në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), Ministrinë e Financave (MF) dhe me konsulencën e Bankës Botërore (BB), ka nisur që në vitin 2013 procesin e reformimit dhe përmirësimit të sistemit të sigurimeve shoqërore. Në përfundim të këtij procesi në vitin 2014, është konkretizuar reforma në tërësi e sistemit të sigurimeve shoqërore e cila u sanksionua me hartimin dhe miratimin e disa akteve ligjore e nënligjore. Viti 2015 është viti i parë i implementimit të kësaj reforme e cila parashikohet të shtrihet për një perspektiv afat gjatë deri në vitin 2056, prandaj dhe KLSH në këtë auditim u përqendrua edhe në sinjalet e para që vinë nga implementimi i kësaj reforme si dhe një vlerësim lidhur me pritshmëritë e reformës për një perspektivë afatshkurtër, pse jo afatmesme dhe afatgjatë.

Nga të dhënat e mbledhura dhe të audituara arritëm në konkluzionin e përgjithshëm se: Me gjithë përpjekjet dhe punën e mirë të evidentuar gjatë këtij viti në administrimin e kujdesshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore, u konstatuan përsëri problematika që kanë ndikuar negativisht në treguesit financiar dhe në qëndrueshmërinë fiskale të këtij sistemi. Konstatuam se edhe pse rezultati i vitit 2015, ka qenë me fitim në shumën 1,320,096,585 lekë, përsëri financimi nga buxheti të shtetit për të balancuar buxhetin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore mbetet tepër i lartë. Kështu, shpenzimet e përgjithshme të sistemit të sigurimit shoqëror janë në shumën 107,308,683,372 lekë; ndërsa të ardhurat nga kontributet janë në shumën 66,147,947,332 lekë dhe këto të ardhura mbulojnë vetëm 60.1% të këtyre shpenzimeve. Diferenca prej 42,480,832,625 lekë është financuar nga buxheti i shtetit dhe në

këtë financim, vetëm deficitin neto i sistemit të pensioneve që subvencionohet direkt nga buxheti i shtetit është në masën 27,632,200,000 lekë dhe zë 32% të shpenzimeve neto të pensioneve publike në Shqipëri, ose 1.92 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Pra impaktet pozitive në vitin e parë që ka sjellë zbatimi i kësaj reforme janë ende larg pritshmërisë. Nisur nga gjendja e treguesve fiskalë të skemës së sigurimeve shoqërore në kuadër dhe në vazhdim të strategjisë së kësaj reforme e gjykojmë të rëndësishme marrjen e masave ligjore dhe organizative nga aktorët kryesorë shtetërorë që mund të garantojnë suksesin e kësaj reforme si ISSH, MMSR, MF, Ministrisë së Bujqësisë së Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (BZHRAU) dhe Këshillin e Ministrave (KM).

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2015.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

I. Mbledhja e ardhurave nga kontributet.

Buxheti ISSH për vitin 2015 i miratuar me Ligjin Nr. 160/2014, datë “Për buxhetin e vitit 2015” për skemën e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe për skemën e sigurimit suplementar është gjithsej 108,371.3 milion lekë. Të ardhurat nga mbledhja e kontributeve në total janë 59,888 milion lekë dhe transferta nga buxheti i shteti për balancimin e këtij buxheti është 49,483.3 milion lekë. Bazuar në bilancin financiar të ISSH, të ardhurat janë realizuar në shumën 60,147.9 milion lekë, dhe paraqiten me një tejkalim në shumën 259.5 milionë lekë ose në masën 100.4 %. Sipas institucionit, në realizimi dhe tejkalimin e të ardhurave të këtij viti, është rritja e numrit të kontribuuesve të cilët në krahasim me vitin 2014 kanë një rritje me 63,507 kontribuues. Nga DPT, janë mbledhur të ardhura në shumën 57,552.8 milionë lekë nga 56,688 milionë lekë të planifikuara ose të ardhurat janë realizuar në masë 101.5 % me një tejkalim në vlerë absolute prej 864.8 milionë lekë. Këto të ardhura DPT i ka mbledhur nga 571,455 kontribuues që punojnë në sektorin publik dhe në sektorin privat nga 480,789 kontribuues të vitit 2014. Ndërsa mbledhja e të ardhurave nga kontributet e të vetpunësuarve në bujqësi dhe nga sigurimi vullnetar i është ngarkuar ISSH.

Nga Sektori Publik: Të ardhurat janë realizuar në shumën 25,888.2 milion lekë, dhe paraqiten me tejkalim në shumën 140.2 milion lekë, ose 105%. Të ardhura janë realizuar apo janë mbledhur nga 145,746 kontribuues të cilët punojnë në sektorin publik. Rritja e të këtyre të ardhurave nuk ka ardhur nga rritja e numrit të kontributeve sepse në vitin 2015 në sektorin publik numri i kontribuuesve është ulur për 13,457 kontribuues për shkak të shkurtimeve të vendeve të punës si pasojë e reformës administrative vendore nga e cila u shkurtuan rreth 13,000 punonjës. Konstatohet që rritja ka ardhur nga shlyerja e detyrimeve të mbartura të sektorit publik nga viti 2014 në shumën 88.8 milion lekë dhe diferenca prej 51.4 milion lekë ka ardhur nga rritja e bazës kontributive për shkak të ndryshimeve të sjella nga përmirësimet ligjore.

Në kuadër të reformës së sigurimeve shoqërore ka dalë Ligji nr. 66/2015 “Për faljen e gjobave për mospagim në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridik dhe fizik”. Pavarësisht këtij incentivi por edhe të mundësive të krijuara nga Strategjia e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, konstatojmë se mbetet shqetësuese gjendja tepër e lartë e debitorëve për kontribute të pa derdhura të trashëguar para vitit 2015 (e në vijim) nga subjekte buxhetore dhe jo buxhetor, çka tregon qartë se iniciativat e marra nuk kanë dhënë efektet e pritshme, pasi nuk ka ulur nivelin e debitorëve. Kështu, vetëm në **sektorin buxhetor** në fund të vitit 2015 paraqiten debitorë për kontribute të pa derdhura 1,168 subjekte buxhetore me detyrim total prej 1,252.7 milion lekë (kontribute, gjoba dhe kamatëvonesë). Nga ky detyrim i përgjithshëm, 869.9 milion lekë janë kontribute të pa derdhura nga 492 subjekte buxhetore. Vlerën më të madhe të këtij detyrimi e kanë: Reparti ushtarak 4303, me detyrim 194,515,723 lekë, Reparti ushtarak 4451, me detyrim 73,879,803 lekë, Reparti ushtarak 4460, me detyrim 68,043,345 lekë, Bashkia Kukës, me detyrim 43,248,596 lekë, AKBN me detyrim 40,318,332, ALUIZNI i Qarku Tiranë, me detyrim 34,315,647 lekë, etj. *Mos derdhja e kontributeve të punonjësve të subjekteve buxhetore, përveç mungesës së të ardhurave të vitit ushtrimor, ndikon negativisht edhe në mbulimin individual të periudhave të sigurimit, sepse në rast se, nuk kryhet pagesa e kontributeve nuk paraqiten edhe listëpagasat për kontributet individuale, çka sjell humbje të periudhave të sigurimit të çdo kontribuuesi, pra këto periudha nuk njihen si vjetërsi pune për përfitimin e pensionit të pleqërisë, trajtuar më hollësisht në faqen ____-, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Meqenëse subjektet debitorë janë institucione publike dhe për punonjësit që kanë punuar mos derdhja e kontributeve nga vetë institucioni, sjellë humbjen e periudhave të sigurimit për ta, ISSH nëpërmjet MF dhe MMSR të hartojnë një projekt vendim të KM për të realizuar pagesën e këtyre detyrimeve të institucioneve publike, të shoqëruar me falje të kamatëvonesave dhe gjobave, duke siguruar jo vetëm uljen e debitorëve por atë që është më e ndjeshme për qytetarët, njohjen e periudhave të sigurimit me kontributet individuale të këtyre punonjësve.

Menjëherë

Nga Sektori Privat: Të ardhurat janë realizuar në shumën 30,010.6 milion lekë, dhe paraqiten me tejkalim në shumën 139.3 milion lekë, ose 101%. Këto të ardhura janë realizuar apo mbledhur nga 425,709 kontribuues të cilët punojnë në sektorin privat. Po të krahasojmë numrin e kontribuuesve të këtij sektori në këtë vit me faktin e vitit 2014 kemi një rritje të ndjeshme nga 313,054 kontribuues në 425,709 ose më tepër 112,655 kontribuues, çka tregon që rritja e të ardhurave nuk ka ardhur në proporcion të drejtë me rritjen e kontribuuesve. Sepse numri i kontribuuesve rritet në fakt në vitin 2015 me 36%, ndërsa të ardhurat faktike të mbledhura nga sektori privat janë rritur vetëm me 7.9% të krahasuar me vitin 2014. Pra nga kjo analizë e thjeshtë, dalin rezerva të konsiderueshme si në planifikimin dhe në mbledhjen e të ardhurave, ndërkohë që shtylla kryesore e reformës të sistemit të sigurimeve shoqërore ka qenë rritja e pjesëmarrjes në skemë të kontribuuesve, si dhe e bazës kontributive (*paga mbi të cilën paguhen kontributet*) me qëllim rritjen e të ardhurave dhe pakësimin e deficitit të skemës së pensione. Megjithatë pritshmëria që do të vinte nga zbatimi i kësaj reforme ka qenë e madhe e veçanërisht në mbledhjen e të ardhurave nga ky sektor, kjo reformë nuk ka rezultuar efikente dhe nuk ka dhënë rezultatet e pritura në vitin e 2015 që është viti i parë i zbatimit, çka nuk të bën optimist për përmirësimin e situatës edhe për vitet në vazhdim.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe mbledhjen e këtyre kontributeve nga DPT u konstatuan disa shkelje dhe parregullsi që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë negativisht në administrimin e këtij procesi dhe në marrëdhëniet e DPT me ISSH në se nuk do të merren masa për të ardhmen. Konstatuam se, DPT për planifikimin e të ardhurave nga kontributet për vitin 2015

ka dërguar në ISSH në kundërshtim me kreun VI të VKM nr. 77, datë 28.01.2015, vetëm shumën totale të të ardhurave prej 30,150 milion lekë. Këtë shumë e ka llogaritur duke u mbështetur në të ardhurat faktike të vitit 2014 dhe i ka shtuar apriori edhe 8.3% të tjera. Kjo shumë nuk është shoqëruar me të dhëna analitike për, numrin e saktë të bizneseve, llojit të tyre, numrin e kontribuuesve të çdo biznesi, pagën reale mbi të cilën paguhen kontributet, si dhe shtesën në planifikim që do të vinte nga shlyerja e debitorëve, etj. Në këto kushte, në ISSH mungojnë analizat e plota në lidhje me planifikimin e treguesve të të ardhurave, pritshmëria që do të vinte nga lufta e informalitetit etj. Për pasojë mbi bazën e të dhënave sintetike që ka ISSH nuk mund të konkludohet mbi mundësitë reale dhe rezervat në planifikimin e të ardhura dhe në dinamikën e rritjes së tyre vit pas viti. Edhe gjatë vitit ushtrimor në kundërshtim me kreun VI të VKM nr. 77, datë 28.01.2015, DPT nuk ka dërguar në ISSH të dhëna periodike dhe progresive për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave.

Nga analizimi i të ardhurave faktike nga kontributet e këtij sektori të marra nga ISSH në rrugë operative (jo zyrtare) për vitin 2015, konstatohet se rreth 50% e kontribuuesve, paguajnë kontribute në nivelin e pagës minimale, kjo më e theksuar në bizneset fason dhe përgjithësisht në të gjithë të punësuarit në biznesin e vogël. Ndërkohë duke ju referuar të dhënave të tregut të punës sipas anketës së forcave të punës të botuara nga INSTAT, konstatohet përsëri një nivel informaliteti i lartë, *statistikat nxjerrin edhe 66,393 punonjës të cilët rezultojnë si të punësuar në sektorin privat jo bujqësor, të cilët nuk janë kontribuues sepse nuk kanë derdhur kontributet në DPT*. Konkretisht, sipas të dhënave të botuara nga INSTAT mbi punësimin e vitit 2015, rezultojnë se nga 1,086,612 persona të punësuar dhe të vetëpunësuar, 448,770 ose 41.3 % e tyre janë të vetëpunësuar në bujqësi, ndërsa 637,848 ose 58.7% e tyre janë të punësuar në sektorin jo bujqësor. Këto të dhëna të krahasuara me numrin e kontribuuesve të sektorit jo bujqësor për vitin 2015 tregojnë se në këtë sektor niveli i informalitet (punës së zezë) është përsëri i lartë dhe arrin mbi 10.4% (66,393/637,848).

Mbetet shqetësim fakti i përkeqësimit të gjendjes së debitorëve edhe gjatë vitit 2015. Kështu, nga një analizë e bërë në lidhje me shlyerjeve e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja u konstatua se, në fund të vitit 2015 gjendja e debitorëve në total është shtuar rreth 508,8 milion leke në krahasim me fundin e vitit 2014 dhe vetëm në sektorin privat detyrimet janë rritur në shumën 597.7 milionë lekë nga e cila biznesi i vogël është shtuar për 821.6 milion lekë, ndërsa biznesi i madh është ulur rreth 223.8 milion lekë. Në fund të vitit 2015, rezultojnë 45,008 subjekte debitorë, nga 48,874 subjekte debitorë në fund të vitit 2014, ose janë pakësuar 3,866 subjekte. Ndërkohë detyrimet e prapambetura të subjekteve debitorë (kontribute, gjoba, interesa, kamatëvonesa) në fund të vitit 2015 janë 10,526,406 mijë lekë nga 10,017,530 mijë lekë që kanë qenë në fund të viti 2014 ose janë rritur në vlerën totale 508,8 milion lekë. Nga totali i detyrimeve prej 10,526.4 milionë; vetëm detyrimet për kontribute të pa derdhura janë 6,342.4 milion lekë, ndërsa gjoba janë në vlerën 2,672.7 milion lekë dhe interesa janë në vlerën 1,511.3 milion lekë. Duke qëndruar në këtë kontekst, duhet theksuar fakti se, në fillim të vitit 2015 me ligjin nr. 66/2015 “Për faljen e gjobave.....” janë falur vetëm gjobat për pagesat e vonuara, mirëpo efektet e zbatimit të këtij ligji nuk reflektohen në ISSH sepse nga DPT e cila kishte përgjegjësinë e zbatimit të tij nuk ka dërguar të dhëna analitike në lidhje me numrin kontribuuesve dhe pagesën e kontributeve të shlyera. Rritja e debitorëve si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik, përveç mungesës së të ardhurave të vitit ushtrimor, ndikon negativisht edhe në mbulimin individual të periudhave të sigurimit, sepse në rast, nuk kryhen pagesat e kontributeve dhe nuk paraqiten listëpagasat për kontributet individuale, çka sjell humbje të periudhave të sigurimit të çdo kontribuuesi.

Problem tjetër madhor vazhdojnë të mbeten procedurat e ndjekura për dërgimin, ruajtjen dhe arkivimin e listëpagesave në bazë të të cilave krijohen llogaritë individuale të periudhave të sigurimit për kontribuuesit që do të shërbejnë për llogaritjen e përfitimit të pensioneve. Edhe pse ekziston e gjithë infrastruktura e nevojshme për kryerjen me sukses të kësaj procedurë konstatohen probleme që lidhen me transmetimin e të dhënave nga DPT në ISSH. ISSH ka kryer një ri-inventarizim fizik në shkallë vendi të gjendjes (numrit) të listëpagesave për të dy

sektorët, publik dhe privat dhe në fund të vitit 2015, gjendja e listëpagesave të periudhës 2005-2012, paraqitet me mungesa prej 1,967,397 listëpagesa të formatit letër. Pas vitit 2012, sipas VKM nr. 55, datë 03.02.20110 “Për deklarimet e detyrueshme të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, i ndryshuar, duke filluar nga 1.01.2013 pagesat e kontributeve dhe listepagesat do të dërgohen dhe komunikohet on-line në format elektronik direkt në ISSH, mirëpo DPT vetëm gjatë muajit prill të vitit 2015 arriti të optimizojë programin e transmetimit dhe filloi të dërgoi on-line në ISSH të gjithë listëpagesat e formatit elektronik të periudhës janar 2013-dhjetor 2014 të cilat në total janë 2,069,776 listëpagesa. DPT edhe gjatë periudhës janar-dhjetor 2015 nuk ka arritur të transmetojë në sistemin informatik të ISSH asnjë listë pagesë. Ky informacion filloi të transmetohet me vështirësi vetëm mbas datës 1 janar 2016, dhe deri në momentin e auditimit kanë ardhur në bazën e të dhënave të ISSH vetëm listëpagesat e muajit janar-prill 2015;

Në strukturën e të ardhurave është përfshirë edhe zëri të ardhura të tjera të cilat janë në total në shumen 574 milion lekë. Këto të ardhura përfaqësojnë, kontributet e derdhura apo një pjesë të kontributeve të derdhura në llogaritë e DPT, si dhe kamatëvonesa dhe gjoba që lidhen me mospagesën e kontributeve brenda afateve të caktuara. Këto të ardhura janë të pa shoqëruara me dokumente vërtetues siç është listëpagesa e kontributeve individuale. Pra, edhe pse kontribuuesit kanë paguar kontributet ato mbeten të pa evidentuara në historikun e tyre të kontributeve.

Është fakt se në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve suplementare të personave juridike e fizike mbledhen nga DPT, e cila bazuar në kërkesat e ligjit për procedurat tatimore dhe të një sërë kërkesave të tjera të përcaktuara në akte të veçanta nën ligjore, është përgjegjëse direkte për administrimin e këtyre kontributeve, duke filluar nga plani i të ardhurave për kontributet, përcaktimi i bazës së kontributeve sipas pagës reale, pagesës dhe derdhjen në afat të saj, vlerësimin në rast mos pagese dhe derdhjen e saj, mbledhjen e debitorëve, të gjobave, të kamat vonesave të kontroleve kundër informalitetit dhe deri në administrimin e procesit të transmetimit të dokumentacionit për kontributet e derdhura, në ISSH. Mirëpo, edhe pse marrëdhëniet e ISSH me DPT janë mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore, në të shumtën e rasteve këto aktet ligjore e nënligjore nuk janë respektuar nga DPT, çka ka sjelle si pasojë shkeljet dhe parregullsitë e trajtuar më lartë të cilat janë në kundërshtim me, nenin 5 të Ligjit 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore” dhe me kreun IV,V dhe VI të VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimit shëndetësor”. Konkludojmë se këto shkelje dhe parregullsi kanë ndikuar negativisht në performancën e administrimit të sistemit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe eliminimi i tyre është mjaft i rëndësishëm si për funksionimin në përgjithësi të sistemit të sigurimit shoqëror dhe në veçanti për uljen e deficitit buxhetor të degës së pensioneve por edhe në fushën e të drejtës individuale të kontribuuesve për përfitimet e pensioneve, pasi si pasoje e këtyre parregullsive krijohen premisa për humbje të viteve kontributive *trajtuar më hollësisht në faqen , të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

a. ISSH nëpërmjet MMSR dhe MF të marri iniciativën ligjore për të hartuar një udhëzim të Këshillit të Ministrave, ku të përcaktohen:

- Procedurat dhe rregullat e transferimit on-line elektronik apo shkresore të listëpagesave mujore të subjekteve fizik dhe juridik (*private dhe publike*) në kohë reale,
- Procedurat dhe rregullat e dërgimit të të dhënave në formatin elektronik apo shkresor për numrin e punonjësve, kontributet e paguara, detyrimet e papaguara, të dhëna përmbledhëse të listëpagesave, etj, nga DPT në ISSH,

- Procedurën e arkëtimit për llogari të fondit të sigurimeve shoqërore, të gjithë të ardhurave e tjera të pa identifikuar, që mblihen nga DPT, duke përfshirë kamatëvonesa dhe gjoba që lidhen me mospagesën e kontributeve në kohë,
- Detyrimet të ndërsjellat si dhe seksionet për mos përmbushje të detyrimeve.

Brenda muajit nëntor 2016

b. ISSH nëpërmjet MMSR dhe MF të marri iniciativën ligjore për të bërë një shtesë në nenin 13 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” për të rregulluar problematikën që krijohet lidhur me njohjen e periudhave të sigurimit për efekt pensioni në rastet e mos derdhjes së kontributeve të personave të punësuar nga punëdhënësit e tyre, duke penalizuar punëdhënësit dhe jo punëmarrësin.

Brenda muajit nëntor 2016

2. Zbatimi i Programit të të ardhurave në përgjegjësi të ISSH:

Nga ISSH janë mbledhur të ardhura nga kontributet e të vet punësuarve në bujqësi dhe nga sigurimi vullnetar në shumën 2,681.9 milion lekë nga 3,338 milion lekë të planifikuara, ose 80.3%, me një mosrealizim më pak prej 656 milionë lekë.

Të ardhurat nga kontributet e të vetpunësuar në bujqësi janë realizuar në shumën 2,035.6 milion lekë, dhe paraqiten me mosrealizim në shumën 712,385 milion lekë, ose janë realizuar 74.1 %. Këto të ardhura janë realizuar apo mbledhur nga 89,527 kontribuues të cilët kryejnë aktivitetet në sektorin bujqësor. Konstatuam se mosrealizimi i të ardhurave ka ardhur nga mosrealizimi i numrit të kontribuuesve të planifikuar i cili rezulton me mosrealizim prej 5,674 persona. Po kështu edhe në krahasim me vitin 2014 numri i kontribuuesve të vetpunësuar në bujqësi në vitin 2015 është ulur me 38,201 kontribuues më pak. Fillimisht, ISSH për vitin 2015, ka planifikuar numrin e të vetpunësuarëve në bujqësi me 125,796 persona nga të cilët do të mblihdeshin 3,082 milion lekë të ardhura. Ky programim është hartuar sipas të dhënave për bilancin e popullsisë agrare nga buletinet zyrtare të INSTAT dhe nga eksperiencia e viteve të mëparshme. Por ky planifikim fillestar prej 125,796 persona, për shkak të mosrealizimit të numrit të kontribuuesve sidomos gjatë periudhës janar- korrik 2015, është korrigjuar duke e ulur në 95,201 persona ose 30,995 persona më pak. Mirëpo, po ti referohemi të dhënave të INSTAT, të Ministrisë së Bujqësisë së Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe vetë të dhënave të ISSH për bilancin e popullsisë agrare të cilat administrohen në ISSH, konstatohen rezerva të konsiderueshme në planifikimin dhe në mbledhjen e të ardhurave. Kështu sipas, buletinit zyrtar të INSTAT për vitin 2015 numri i personave të vetpunësuar në bujqësi përbën 41.3 % të numrit të përgjithshëm të punësuarve prej 1,086,612 persona, ose të punësuar në bujqësi janë 448,770 persona. Ky numër personash sipas statistikave të MBZHRAU është i punësuar në 352,315 ferma bujqësore (subjekte). Sipas të dhënave që disponon vetë ISSH persona në fshat që trajtohen me ndihmë ekonomike janë 159,345 persona dhe persona të tjerë të cilët edhe pse kanë përfituar tokë nga Ligji 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, por për arsye të ndryshme nuk e zotërojnë atë, janë gjithsej 81,031 persona. Po të zbrisim numrin e këtyre persona të cilët nuk paguajnë kontribute, nga numri total i të punësuarve në bujqësi prej 448,770 persona, dalin të punësuar me mundësi reale për të kontribuar 208,000 persona dhe jo 125,796 persona të planifikuar fillimisht, apo më pas i ndryshuar duke e ulur planifikimin me 95,201 persona. Pra, plani i të ardhurave nga kontributet e të vetpunësuarve në bujqësi duhet të planifikohet për 208,000 persona me kontribut mesatar vjetor 29,149 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 6,063 milion lekë dhe jo 2,748 milion lekë, pra janë planifikuar më pak rreth 45 % të të ardhurave potenciale për tu mbledhur. Megjithatë konstatohen rezerva në planifikimin fillestar të të ardhurave për të vetpunësuarit në sektorin bujqësor, për shkak të mosrealizimit të numrit të kontribuuesve, të ardhurat e programuara prej 2,748, milion lekë u realizuan në shumën

2,035,6 milionë lekë, pra më pak në shumën 712,4 milionë lekë ose realizuar në masën 74.1%. Faktorët që kanë influencuar në mosrealizimin e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarëve në bujqësi kryesisht janë niveli i ulët ekonomik i popullsisë rurale dhe veçanërisht i zonave malore; mungesa e të ardhurave të familjeve fermerë, këtui ndikon edhe frenimi dhe rënia e dërgesave të emigrantëve (*renimitancat*); mos derdhja e kontributeve të bujqve të cilët edhe pse kanë përfituar tokë nga Ligji 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, për arsye të ndryshme nuk e zotërojnë atë, braktisja e forcave të punës nga lëvizjet në emigracionin sezonal dhe i përhershëm, që këtë vit ka qenë mjaft i konsiderueshëm.

Veçanërisht në mosrealizimin e këtyre të ardhurave ka influencuar Ligji nr. 153/2014, datë 18.11.2014 “Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi” që shumë të vetëpunësuar në bujqësi-gjatë muajit dhjetor 2014, kanë përfituar nga ky ligj dhe kanë blerë periudha të gjata sigurimi duke plotësuar vjetërsinë në punë dhe nuk vazhdojnë të sigurohen, pra kanë ndërprerë pagesën e kontributeve. Sigurimi minimal qoftë edhe për përfitimin e një pensioni minimal, si dhe rritja graduale të tarifës së kontributit e cila sipas nenit 90 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, parashikon se, brenda tre viteve kjo tarifë do të barazohet me tarifën e kontributeve të vetëpunësuarëve në qytet, nuk e bëjnë këtë skemë nxitëse për interesimin e pagesës së kontributit, çka nuk të jep edhe optimizëm se, të ardhurat nga këto kontribute do të shtohen edhe në vitet në vazhdim.

Mos mbledhja e të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi ka thelluar ndjeshëm deficitin e degës së pensione të fshatit të krahasuar me tre vitet e mëparshme. Sistemi i sigurimeve të detyrueshme në Shqipëri, që nga viti 1967 e në vazhdim, ka trajtuara të ndara dy skema, skemën e pensioneve shtetërore dhe skemën e pensioneve për fshatin. Kjo ndarje bëhet për shkak të periudhës kontributive për fshatin e cila lidhet me ish kooperativat bujqësore si dhe me formulën e llogaritjes së përfitimit të pensioneve. Kështu, masa e pensionit të qytetit fillon me 15,000 lekë në muaj dhe masa e pensionit për fshatin fillon me 8,330 lekë në muaj. Me skemën e re, llogaritja e pensionit është unifikuar, por ende në skemën e pensioneve të fshatit janë 144,770 përfitues (*pensionistë të cilët kanë periudha kontributeve në kooperativa, para vitit 1990*), dhe për këtë arsye treguesit dhe rezultati financiar i kësaj skeme, analizohet më vete. Kështu, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, sigurimet shoqërore të detyrueshme mbrojnë me përfitime të vetëpunësuarin në bujqësi për barrëindjet, për pension pleqërie, pension invaliditetin dhe pension për humbjen e mbajtësit të familjes. Bazuar në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 të vetpunësuarit në bujqësi paguajnë kontribute sipas një tarife kontributive vjetore e cila për zonat fushore është 33,000 lekë në vit dhe për zonat kodrinore malore është 25,300 leke në vit. Periudha e sigurimit të vetëpunësuarve në bujqësi për efekt pensioni njihet e njëjtë si për të vetëpunësuarit në qytet pavarësisht se, tarifa e kontributit vjetor është mesatarisht rreth 52 % më e ulët se e qytetit dhe diferenca për kontributet e tyre mbulohet nga buxheti i shtetit. Kjo tarifë do të rritet në mënyrë graduale dhe brenda tre viteve barazohet me kontributin e qytetit. Të ardhura nga kontributet e vetëpunësuarve në fshat janë në shumën 4,210,585 mijë lekë në të cilën përfshihen kontributet e drejtpërdrejta nga fermerët dhe kontributi e pjesës së shtetit për këta fermerë. Shpenzimet për pensionet e fshati janë në shumën 14,347,598 lekë dhe i kanë përfituar 144,769 persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti apo pensione familjare, shpenzimet për barrëindjet janë në vlerën 579,289 lekë dhe kanë përfituar 6,695 gra, dhe shpenzimet në total shkojnë në shumën 14,926,887 lekë. Pra, skema e pensioneve për fshatin paraqitet me një deficit prej 10,716.3 milion lekë (14,926,887 - 4,210,585) dhe e krahasuar me vitin 2014 deficit është thelluar me 436 milion lekë më shumë ose është rritur për 4%. Por ky deficit është edhe më i lartë, po të zbrisim nga të ardhurat totale prej 4,210.58 milion lekë pjesën e kontributeve që mbulohet nga buxheti i shtetit për diferencë midis kontributit që paguan i vetëpunësuarit në bujqësi me kontributin minimal të njohur me VKM nr. 77, datë 28.01.2015, i cili është në shumën 2,261 milion lekë. Kështu, deficitin që rezultojn për këtë skemë, bazuar në kontributet e derdhura dhe në përfitimet e drejtpërdrejta të degës së pensioneve të fshatit është 12,654.3 milion lekë, ose kundrejt PBB është 0,87%. Dhe duke

ju referuar shpenzimeve për pensionet e fshatit (*pa barrë lindjet*) të cilat janë në total 14,347.59 milion lekë del që buxheti i shtetit financon këto shpenzime në shumën 12,654.3 milion lekë, ose mbulon rreth 88.2% të këtyre shpenzimeve, çka tregon që kjo skeme nuk mund të konsiderohet kontributive. Duke qëndruar në përfitimet e skemës së fshatit, përveç sa më sipër edhe përfitimet e barrëlindejeve të cilat janë përfitime afatshkurtra dhe logjikisht duhet të mbulohen më kontributet e vitit, përsëri konstatohet një deficit në shumën 322.9 milion lekë.

Në përfundim të auditimit konkludojmë që deficitin e skemës së pensioneve të fshatit rezultojnë mbi 12,654.3 milion lekë dhe përbën 88.2% të shpenzimeve ose 0.87% të PBP. Pra megjithëse kjo skemë shërben si një element i rëndësishëm për zbutjen e varfërisë dhe mbulimin e popullsisë së fshatit me pensione, ajo “de fakto” është pothuajse totalisht e subvencionuar nga buxheti i shtetit. Siç u trajtua më sipër, sipas ligjit nr. 7703, 11.05.1993, brenda 4 viteve tarifa e kontributeve të fshatit do të barazohet me tarifën e kontributeve të qytetit dhe buxheti i shtetit nuk do të subvencionojë diferencën e kontributeve, por edhe nëse këto kontribute të fshatit do të barazohen, referuar pjesëmarrës aktuale të fermerëve në këtë skemë në të cilën kanë marrë pjesë vetëm 89,527 persona (kontribues), përsëri deficitin do të jetë prezent dhe tepër i konsiderueshëm. Pra, sipas treguesve ekonomik dhe financiar të vitit 2015, skema e sigurimit të fshatit jo vetëm që mbetet problematike për të gjithë skemën e sigurimeve shoqërore, por nuk të jep edhe optimizëm për ecurinë e mirë të këtyre treguesve si dhe për qëndrueshmëri financiare të saj për vitet në vazhdim. Megjithatë, nëse do të mundeshin të futeshin në këtë skemë duke u bërë pjesëmarrës me kontribute të plota 208,000 persona të vetëpunësuar në bujqësi të evidentuara nga INSTAT, kjo skemë mund të përmirësohet ndjeshëm dhe rezultatit financiar i saj mund të arrijë në edhe në balancim të plotë, trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

MMSR, MBZHRAU, MF dhe ISSH, në bashkëpunim edhe me stafet akademike të Universiteteve në vend por edhe me shoqërinë civile të iniciojnë punën për të studiuar në mënyrë të veçantë këtë skemë dhe më pas të marrin iniciativën ligjore për të hartuar një Projekt-Vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilin të koordinohen dhe harmonizohen treguesit e kësaj skeme me masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë së zhvillimit bujqësor, me qëllim arritjen e pjesëmarrjes në skemën e sigurimit shoqëror të gjithë të vetëpunësuarve që kryejnë aktivitet ekonomik në sistemin e bujqësisë.

Ndërkohë ISSH, të hartojnë një Projekt Vendim për Këshillit të Ministrave për të përcaktuar qartë detyrimin e pagesës së sigurimeve shoqërore në mënyrë të vijueshme nga të vetëpunësuarit në bujqësi që trajtohen me subvencione shtetërore të lidhura me aktivitetin bujqësor.

Brenda muajit nëntor 2016

II. Shpenzimet që rrjedhin nga përfitimet

Për vitin 2015 shpenzimet faktike për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore janë realizuar në shumën 107,309 milion lekë, kundrejt planifikimit që ka qenë në shumën 108,371.3 milion lekë ose janë realizuar në masën 99% dhe paraqiten me kursim në vlerë absolute 1,063 milion lekë. Peshën më të madhe rreth 83% të shpenzimeve totale e zënë shpenzimet për sigurimin e detyrueshëm që kanë të bëjnë me pensione pleqërie, barrë lindje, sëmundje, etj (*skema publike*), dhe administrohen direkt nën përgjegjësi të ISSH. Ndërsa shpenzimet që rrjedhin nga ligje të veçanta që përfaqësojnë përfitimet për pensione speciale dhe të veçanta shtetërore si dhe pensione suplementare për disa kategori punonjësish kushtetues dhe të administratës publike, zënë rreth 15% të shpenzimeve totale dhe administrohen nga ISSH për llogari të qeverisë.

1. Shpenzimet për sigurimin e detyrueshëm.

Shpenzimet për sëmundje janë realizuar në shumën 330.7 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 82.23 % ose janë shpenzuar më pak 71.48 milion lekë. Shpenzimet për barrë lindje janë realizuar në shumën 2,490.4 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 99.4 % ose janë shpenzuar më pak 14.4 milion lekë. Shpenzimet për aksidente dhe sëmundje profesionale janë realizuar në shumën 12 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 94.5 % ose janë shpenzuar më pak 0.7 milion lekë. Arsye e uljes së këtyre shpenzimeve ka ardhur nga ndryshimi i formulës së llogaritjeve të përfitimeve, pasi për llogaritjen e këtyre përfitimeve nuk i referohesh pagës bruto siç ka qenë e përcaktuar para ndryshimeve ligjore, por tashmë, sipas nenin 22 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 i referohet pagës neto, çka është bërë që niveli i këtyre përfitimeve të ulet. Ndërsa shpenzimet për pensione në total janë realizuar në shumën 86,071 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 99.48 ose janë shpenzuar më pak 448.1 milion lekë në krahasim me planin e vitit. Këto shpenzime përbëhen nga shpenzime për pensionet e qytetit që janë realizuar në shumën 71,993 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 98.3% ose janë shpenzuar më pak 1,245 milion lekë dhe shpenzime për pensione në fshat që janë realizuar në shumën 1, 407 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 106 % ose janë shpenzuar më tepër 797.48 milion lekë. Në këto shpenzime përfshihen edhe pensionet për paaftësi (*invaliditet*) dhe pensione mbijetese (*familjare*). Dhe po ti krahasojmë me vitin 2014, kemi një rritje të konsiderueshme të përfitimeve që shkojnë në total në shumën 3,707 milion lekë, ose 4,5 % më tepër. Kjo rritje ka ardhur, nga shtimi i numrit neto të përfituesve në vitin 2015 pasi, në këtë vit kanë mbushur moshën e pensionit të lindurit gjatë periudhës së viteve 1950-1960, përdhë e cila njihet për lindshmëri të lartë (*periudha e baby boom*), dhe nga shtesa për shkak të indeksimit të pensioneve si pasojë e ndryshimit në rritje të indeksit të çmimeve. Kështu, gjatë vitit 2015 janë trajtuar me pagesa përfitimi rreth 598.932 pensionistë të të gjitha kategorive dhe krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje të numrit të përgjithshëm të përfituesve me 13,451 pensionistë më shumë. Rritja më e madhe konstatohet në pensionet e pleqërisë, me 13,703 pensione më shumë se viti i kaluar, por edhe pensione invaliditeti me 1,075 pensione më shumë, ndërsa pensionet familjare janë ulur me 1,374 pensione më pak. Konstatua se megjithëse sipas ligji nr. 7703 “*Për sigurimet shoqërore*”, afati i caktimit të pensionit është 45 deri në 60 ditë nga paraqitja e kërkesës për pension, gjatë vitit 2015 nga 37,441 pensione të reja, 9% e tyre ose 3.207 pensione janë lidhur jashtë këtij afati ligjor.

Pranë degëve të përfitimeve të ISSH janë ngritur komisionet e pensioneve për shqyrtimin e ankesave të pensionistëve. Megjithëse këto komisione, gjatë këtij viti kanë shqyrtuar dhe analizuar mbi 4,400 praktika pensionesh, përsëri mbetet një aspekt shumë i rëndësishëm dhe shqetësim i madh kalimi për shqyrtim i ankesave në gjykata. Proceset gjyqësore të shumta janë hapur si pasojë e pasaktësive në dokumentacionin e domosdoshëm për përfitimin e pensionit, sepse, shpesh këto dokumente paraqiten me probleme, si librezat e punës janë dublikatë; të korrigjuara; me të dhëna të padukshme; ju mungojnë vulat apo nënshkrimet etj; regjistra të korrigjuara dhe me ndryshime thelbësore të emrave; fletë të falsifikuara si dhe fletë të shtuara; regjistra të shkruar me laps plumbi; numra shtesë, apo dokumentacion që mungon për shkak të djegieve; dëmtimeve, etj. Në rast të këtyre parregullsive, refuzohen kërkesat për pension, ose caktohen pensione të pjesshme duke zbritur periudhat e punës të pasakta. Ankesat për këto refuzime shqyrtohen fillimisht nga vetë ISSH-së dhe në rastet e moszgjidhjes së tyre, pensionistët i drejtohen Gjykatave.

ISSH, gjatë vitit 2015 ka pasur dhe ka ndjekur në gjykatat civile dhe administrative të shkallës së parë dhe në gjykatat respektive të apelit 5,734 çështje gjyqësore. Rastet më të shumta të ankimeve në gjykatë e zënë rastet për vërtetimin e vjetërsisë në punë dhe saktësim identiteti. Për vitin 2015 për vjetërsi në punë janë 2,423 çështje dhe për saktësim gjeneralitetesh janë 1,001 çështje. Nisur nga këto të dhëna, evidentohen qartë vonesa të tej zgjatura në caktimin dhe lidhjen e pensioneve. Por përveç vonesave të cilat krijojnë mjaft shqetësime për pensionistët, tej zgjatja e këtyre proceseve mbi 1, 2 apo 3 vjet sjell edhe humbjen e të drejtës për ta marrë pensionin nga data që plotëson moshën, pra pensionistët për shkak të zvarritjeve të proceseve gjyqësore humbasin periudha të tërheqjes së pensionit.

Sepse në zbatim të nenit 62 të ligjit 7703, 11.05.1993 pensioni lidhet nga data që dorëzohen të gjitha dokumentet, përfshi këtu edhe dorëzimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë. Gjithashtu, vendimet gjyqësore në favor të qytetarëve shoqërohen edhe me pagesën e shpenzimeve gjyqësore të cilat janë kosto për buxhetin e ISSH.

Nga ISSH, për pensione të lidhura para vitit 2015 janë bërë në prokurori 2,820 kallëzime penale, të cilat janë vendosur të gjitha në favor të sigurimeve shoqërore, ndërsa vetëm për këtë vit janë bërë 527 kallëzime penale. Objekti kryesor i këtyre kallëzimeve kanë qenë dokumentet me falsifikim të datëlindjeve, falsifikimet në periudhat e sigurimit si dhe tërheqja e pensioneve të dubluara. Si pasojë e këtyre por edhe të disa çështjeve të tjera të fituar në gjykata nga ISSH, në fund të viti 2015 janë shpallur debitorë ndaj ISSH për pensione të tërhequra padrejtësisht 2,967 pensionistë me vlerë të përgjithshme 1,436 milion lekë. Nga këto janë ri arkëtuar 619.1 milionë lekë nga 2,449 pensionistë debitorë.

ISSH ka ngritur në strukturë njësinë e inspektimit të përfitimeve e cila ka për objekt kontrollin dhe certifikimin e përfitimeve të caktuara. Gjatë vitit 2015 kjo njësi ka kryer inspektime dhe kontrolluar 16,236 dosje përfitimi. Nga auditimi i raporteve të inspektimit, evidentuam se, janë konstatuar disa parregullsi dhe shkelje si moszbatim të akteve ligjore e nënligjore që veprojnë në fushën e invaliditetit apo të pensioneve familjare; kapërcim të kompetencave që parashikojnë dispozitat në fuqi; njohje periudha pune vetëm me librezën e punës; komisionet e shqyrtimit të pensioneve në disa raste kanë tejkaluar kompetencat; duke mos plotësuar dosjen me dokumentacionin dhe prova bindëse që vërtetojnë plotësisht marrëdhëniet e punës të përfituesve; në disa përfitime nuk është përcaktuar saktë paga neto mesatare; mbi të cilën është llogaritur masa e pensionit; pagesat kalimtare në disa raste janë paguar përtej afateve të përfitimit, duke mos i qëndruar rigoroz përcaktimeve ligjore; në disa raste, për caktimin e përfitimeve suplementare, nuk janë mbajtur parasysh përcaktimet sipas grupit dhe sipas listës së miratuar me VKM; në disa raste të tjera sporadike ka mospërputhje të grupit me mënyrën e llogaritjes së përfitimit suplementar; etj trajtuar më *hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Për respektimin e afatit të caktimit të pensioneve si dhe për uljen e numrit të proceseve gjyqësore të cilat sjellin jo pak shqetësime dhe kosto ekonomike për pensionistët, por ndikojnë ndjeshëm edhe në koston e shërbimeve operacionale gjyqësore si dhe në koston e buxhetin e shtetit, ISSH duhet të përmirësojë procedurat administrative në lidhje me pranimin e dokumentacionit, verifikimin e tij dhe caktimin e pensionit brenda afateve të përcaktuara në nenin 85 të ligjit 7703, 11.05.1993. Për këtë duhet të merret iniciativa ligjore që nëpërmjet MMSR të hartohet një Projekt-Vendim dhe të dërgohet për miratim në KM, ku të përcaktohen rregullat për zgjidhjen në rrugë administrative të të gjitha rasteve kur në dokumentet që përcaktojnë vjetërsinë e punës konstatohen pasaktësi ose parregullsi.

Brenda muajit nëntor 2016

Megjithëse në vitin 2015, kryesisht për shkak të zbatimit të legjislacionit të ri të numri i pensioneve të reja të invaliditetit është më i ulët se në vitet e tjera, përsëri konstatohet rritje e numrit të përgjithshëm të tyre krahasuar me një vit më parë. Pranë ISSH kanë funksionuar 6 KMCAP-et Eprorë. Gjatë këtij viti janë paraqitur në këto komisione për vlerësim rreth 4,148 raste, nga të cilat u shqyrtuan brenda vitit 2,955 invalidë/të sëmurë. Megjithatë nga dosjet e shqyrtuara vetëm 52.5 % e tyre janë kthyer me përgjigje pozitive. Natyrshëm rritja e moshës së daljes në pension si për burrat dhe për gratë, do të sjelli edhe problematika në invaliditet, por përveç kësaj nga njësia e inspektimit e ngritur pranë ISSH me përbeje mjekë, janë konstatuar edhe disa problematika të tjera. Kështu, nga ky sektor, janë kontrolluar 6,892 dosje invaliditeti dhe nga auditimi i raporteve të inspektimit u evidentuam disa shkelje dhe parregullsi, me dëm ekonomik në vlerën 26,417 mijë lekë nga të cilat brenda këtij viti janë arkëtuar 7,791 mijë lekë si dhe shkelje të tjera pa dëm ekonomik. Përmendim disa shkelje të evidentuara: në 373 raste janë shkelur kriteret e përcaktuara për dhënien e shkallës së

invaliditetit; në 124 raste është bërë vendosje e pa rregullt e datës së fillimit të invaliditetit; në 551 raste është konstatuar se, dokumentacion shëndetësor është i pa plote dhe vendimet e KMCAP rajonale janë marrë në kushtet mangësisë dokumentare që vërtetojnë përfitimin e invaliditetit; në 139 raste janë konstatuar, problematika në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë (e drejta për përfitime); në disa raste të tjera, nuk kërkohen ekzaminime të domosdoshme për të vërtetuar vazhdimësinë e sëmundjes çka sjell si pasojë zgjatjen e invaliditetit të pa argumentuar; fletët e drejtimit që lëshohen nga Spitalet Rajonale në një pjesë të konsiderueshme të tyre ka mangësi të ekzaminimeve mjekësore të domosdoshme; në kundërshtim me protokollin e diagnozave, etj.

Po kështu konstatohen, mungesa e specialistëve mjekë në Drejtoritë Rajonale të ISSH, për pasojë njëjti mjek që lëshon fletë epikrizën është edhe anëtar në KMCAP. Gjithashtu mungesa ka edhe në KMCAP- it Epror të Kardiologjisë si dhe të anëtarëve zëvendësueses së këtyre komisioneve sipas përcaktimeve të VKM nr. 505, 10.06.2015 “*Për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve KMCAP- it Epror*”, të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të invalidëve me këto sëmundje. Nisur nga problematikat në administrimi e përfitimit të invaliditetit të mbartura edhe nga vitet e tjera, ISSH në zbatim të VKM nr. 505, 10.06.2015 gjatë këtij viti në bashkëpunim edhe me MMSR dhe kryesisht me Ministrinë e Shëndetësisë ka realizuar ngritjen dhe vënien në funksion të 6 KMCAP-eve Eprorë pranë ISSH si dhe ndarjen veçmas të komisioneve për caktimin e aftësisë për punë të personave që nuk janë kontribuues në skemën e sigurimeve shoqërore, *trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

a. ISSH në bashkëpunim me MSH, të ndërmarrë, një studim me qëllim riorganizimin dhe përcaktimin e procedurave të komisionimit të invalidëve, rishikimin e përbërjes së KMCAP-eve Rajonale si dhe rishikimin e kriterëve të caktimit të aftësisë për punë. Në përfundim të studimit të hartohet një Projekt-Vendim dhe të dërgohet për miratim në KM.

Brenda muajit nëntor 2016

b. ISSH, të marrë iniciativën ligjore për ti propozuar KM, miratimin e listës së zëvendësuesve të anëtarëve të KMCAP-et Eprorë, në zbatim të VKM nr. 505, 10.06.2015, sepse në rast mungese të një anëtari në komisionet mikse, rrezikohet zhvillimi i seancës së komisionimit.

Menjëherë

2. Deficiti i degës së pensioneve të qytetit (pensione shtetërore)

Bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, sigurimi i shoqëror i detyrueshëm jep përfitime për 4 degë të sigurimeve shoqërore, sëmundje, barrë lindje, pensione pleqërie, invaliditeti, familjare dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale. Përfitimet që parashikon ky ligj, financohen: nga kontributet e punëdhënësve, të të punësuarve dhe personave të tjerë ekonomikisht aktive dhe përbëjnë kontributet e drejtpërdrejta, dhe nga kontributet e buxhetit të shtetit për kategori të veçanta personash ku përfshihen të papunët në pagesë papunësie, personat në pagesë kalimtare, ushtarakët në reformë, punonjësit e nëntokës, punonjësit e industrisë ushtarake, gratë që dalin në pension në vitin respektiv si dhe diferencën për kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi. Nga auditimi u konstatua:

Të ardhurat nga kontributet, vetëm për skemën e pensioneve të qytetit, për vitin 2015 janë në shumën 56,455.4 milion lekë, ndërsa shpenzimet për përfitime për skemën e sigurimeve të detyrueshme për qytetin, janë në shumën 73,371.3 milion lekë. Bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet, deficit i vitit 2015 i kësaj dege është në shumën 16,915.9 milion leke dhe zë mbi 22 % të shpenzimeve të degës së pensioneve, ose kundrejt PBB është 1.18%. Deficiti i degës së pensioneve të qytetit ndryshe nga deficit i degës së fshatit ka një ulje në vlerë absolute rreth 544.8 milionë lekë në krahasim me vitin 2014, ose krahasuar me PBB e këtij viti ka një ulje për 0.07%. Megjithatë evidentohet ky përmirësim i gjendjes, deficit i konsiderueshëm në nivelin mbi 22 % të shpenzimeve, do të thotë që kontributet mbulojnë vetëm 78 % të pensioneve mujore, çka tregon që masat e mara për uljen e evazionit të në mbledhjen e

kontributeve dhe sidomos për uljen e numrit të papunëve, të cilët janë një burim mjaft i rëndësishëm për skemën e Sigurimeve Shoqërore, nuk kanë dhënë ende efektet e duhura financiare për përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale të sistemit, trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH të luajë një rol kryesor në oponencën lidhur me të gjitha ndryshimet e mundshme që prekin treguesit kryesorë të skemës, si indeksimi mbi bazë të çmimeve, rritjen e bazës kontributive, etj, të cilat prekin qëndrueshmërinë fiskale të skemës si dhe ndikojnë direkt në nivelin e deficitit dhe ecurinë e programeve të reformës së deritanishme.

Në vijimësi

III. Shpenzimet për pensione të veçanta:

Për këtë kategori përfituesish janë kryer gjatë vitit shpenzime në shumën totale 11,497 milion lekë dhe krahasuar me planin e vitit janë realizuar më pak në shumën 112.7 milion lekë ose janë realizuar 99.3%. Po të krahasojmë këto shpenzime me vitin 2014, kemi rritje të përfitimeve në total në vlerën 569 milion lekë, ose 5.2% më shumë. Shpenzimet për pensione speciale dhe të posaçme janë realizuar në shumën 63.7 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 98,9 % ose janë shpenzuar më pak 22.8 milion lekë. Në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, këto shpenzime kryhen për rastet e përfitimeve për pensione të posaçme që jepen nga shteti për personat që kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta, kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës; kanë vuajtur nga persekutimi politik në regjimin komunist, etj. Kushtet e përfitimit, vlera dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga KM. Sipas VKM nr. 730, datë 02.09.2015, masa e pensionit të posaçëm është përcaktuar që, të mos jetë më e ulët se, dyfishi i pensionit social që është 13,500 lekë dhe jo më e lartë se 4 fish i këtij pensioni që është 27,000 lekë. Kështu deri në këtë vit kanë përfituar pensione të posaçme rreth 250 persona me vlerë totale 63.7 milion. Mirëpo në lidhje me përfitimin u konstatua se, për shkak të indeksimit të pa barabartë të këtij pensioni në vite janë krijuar diferenca mes personave të ndryshëm përfitues, çka do të thotë që për të drejta të barabarta merren përfitime të ndryshme. Kjo diferencë shkon deri në 4 mijë lekë në muaj për përfitues.

Gjithashtu vihet re një tendencë e shtimit të përfitimeve të këtyre pensioneve sepse, në disa raste të veçanta, KM ka marrë vendime përjashtimore për dhënie të pensioneve të posaçme të cilat, përveç se, nuk plotësojnë kriteret baze të përcaktuar në ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, kanë përfituar edhe mbi kufirin maksimal të përcaktuar në VKM nr. 730, datë 02.09.2015, trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH nëpërmjet MMSR ti kërkojë Këshillit të Ministrave që të bëjë indeksimin e këtyre pensioneve me qëllim eliminimin e diferencave të krijuar dhe trajtimin e barabartë të tyre me përfitime, pavarësisht nga viti i dhënies së pensionit të posaçëm. Të ketë një politikë të kujdesshme që këto kategori që trajtohen me përfitime të veçanta të kenë një monitorim të fortë në mënyrë që të mos zgjerohen përfituesit padrejtësisht dhe në çdo rast të dhënies së tyre, masa e përfitimit të caktohet në bazë të kriterëve të përcaktuar në ligji nr. 7703, datë 11.05.1993.

Brenda muajit nëntor 2016

Shpenzimet për shtesë nga Statusi i Invalidit të Punës janë realizuar në shumën 45.2 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 96 % ose janë shpenzuar më pak 1.9 milion lekë. Këto shpenzime përfaqësojnë kundra vleftën e furnizimeve me karburant për invalidët e punës që janë pajisur me mjete lëvizjeje nga ISSH si dhe invalid që i kanë blerë vetë mjetet motorike por që kanë përfituar lehtësira doganore. Kjo skemë është mbyllur që në vitin 2008

me 535 invalidë dhe që nga kjo kohë nuk është zgjeruar më tej. Pra, kundravlehtë e karburanteve i jepet vetëm përfituesve para vitit 2008, ndërkohë që pas vitit 2008 e në vazhdim ka mjaft invalidë të tjerë të cilët, kanë blerë vetë mjetet motorike dhe plotësojnë kriterin e këtij përfitimi, por nuk e gëzojnë këtë trajtim financiar, *trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH nëpërmjet MMSR ti kërkojë Këshillit të Ministrave për të përfshirë në mënyrë korrekte të gjithë personat nën këtë kategori invalidësh në skemën e trajtimit duke përcaktuar edhe nivelin e përfitimit mujor sipas kategorizimit të këtyre invalidëve. Krahas kësaj, ISSH duhet të monitorojë në mënyrë konkrete kriteret që duhet të plotësojë mjeti motorik që ti përshtatet invalidit përfitues.

Brenda muajit nëntor 2016

Shpenzimet për kompensime të energjisë elektrike, janë realizuar në shumën 11,053.5 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 99.6% ose janë shpenzuar më pak 43.4 milion lekë. Këto shpenzime kryhen në zbatim të VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj” dhe masa e kompensimit të energjisë është 648 lekë në muaj. U konstatua se, ka mjaft ankesa në drejtim të ISSH nga disa kategori pensionistësh, që janë të vetëm dhe jetojnë në fshat, dhe nga VKM e mësipërme nuk përfitojnë këtë trajtim. Këta pensionistë janë në kushte të barabarta përfitimi si edhe të pensionistëve që jetojnë në qytet. Më të theksuar janë rastet e pensionistëve që jetojnë në rrethinat e qyteteve të mëdha, që aktualisht kjo VKM i ka trajtuar si fshatra, por për shkak të urbanizimit kanë humbur konceptin e fshatit, p.sh, fshati Paskuqan, Dajt, Kashar, etj *trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH nëpërmjet MMSR ti propozojë Këshillit të Ministrave një skemë të studiuar për mbrojtjen e shtresave në nevojë duke trajtuar me kujdes çdo kategori pensionistësh që plotësojnë kushtet për këtë përfitim.

Brenda muajit nëntor 2016

IV. Shpenzimet për pensionet suplementare

Shpenzimet për pensione suplementare janë realizuar në shumën 4,892 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 93.3% ose janë shpenzuar më pak 347.5 milion lekë. Kjo kategori shpenzimesh përfaqëson përfitimet nga pensionet suplementare si dhe përfitime të tjera të cilat nuk lidhen me skemën publike të pensioneve. Në këtë program administrohet; skema e pensioneve të posaçme, skema e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skema e sigurimeve suplementare të ushtarakëve, pilotëve, ushtarakëve të nëndetëseve, policisë së shtetit, skema e trajtimeve financiare të veçanta për minatorët dhe punonjësit e industrisë ushtarake, skema e trajtimeve të veçanta për familjet e dëshmoreve, si dhe pagesat për rimbursimin e shpenzimeve të funeraleve. U konstatua se në skemën e pensioneve të parakohshme të ish minatorëve, aktualisht trajtohen me përfitime 2,499 persona. Mirëpo u konstatua se, në numrin e personave të planifikuar për përfitim në ligjin 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” nuk janë përfshirë edhe të burgosurit politik por edhe të burgosurit e tjerë të cilët kanë vuajtur vitet e burgimit në regjimin komunist duke punuar në miniera, në nëntokë *trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH nëpërmjet MMSR dhe Ministrisë së Drejtësisë ti kërkojë Këshillit të Ministrave përfshirjen me këtë trajtim financiar edhe këtë kategori personash.

Brenda muajit nëntor 2016

Nga skemat më të kushtueshme të pensioneve suplementare, janë pensionet e ish ushtarakët dhe punonjësve të policisë së shtetit. Këto përfitimet aktualisht, përcaktohen sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve ...”. Mirëpo, ky ligji në vitet e mëparshme është kundërshtuar nga ish-Ushtarakët, në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 33, datë 24.06.2010, ka shfuqizuar kufirin tavan të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të vendosur me këtë ligj, i cili ishte përcaktuar sa dyfishi i pensionit maksimal. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese krijonte efekte të mëdha financiare për buxhetin e shtetit, dhe për këtë KM miratoi Aktin Normativ nr. 5, datë 10.11.2010, i cili ndryshoi rrënjësisht formulën e llogaritjes së përfitimeve. Ky Akt normativ u kundërshtua përsëri në Gjykatën Kushtetuese dhe kjo gjykatë me vendimin e saj nr. 2, datë 18.02.2013 vendosi rrëzimin e kërkesës së ushtarakeve duke lënë në fuqi ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, i cili i shtrinte efektet financiare që nga data 01.07.2009 dhe për pasojë solli rillogaritje të pensioneve të parakohshme suplementare, të 20 mijë ish-ushtarakëve. Nga rillogaritjet dolën 6,738 ish-ushtarakë debitorë, me një shumë prej 1,313.7 milionë lekësh. Nga gjendja e debitorëve, gjatë periudhës 2010- shkurt 2015 janë shlyer 368,5 milion lekë dhe në fund të vitit 2015 kanë mbetur edhe 5,425 ish-ushtarakë debitorë, me një shumë të pa shlyer për 984.5 milion lekë. Për këtë, kjo kategori ish-ushtarakësh ka drejtuar shumë ankesa në disa institucione dhe në prill të këtij viti u miratua ligji nr. 46, datë 28.04.2016 “Për detyrimet që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare....”. Bazuar në këtë ligj janë falur të gjitha detyrimet që kanë mbetur gjendje pa u shlyer si dhe do të kthehen detyrimet atyre që janë shlyer më parë në vlerën 368,5 milion lekë. Pra favorizimi i kësaj kategorie duke i falur këtë detyrim financiar ka rënduar ndjeshëm buxhetin e shtetit me rreth 1,313.7 milionë lekë, trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH nëpërmjet MMSR ti kërkojë Këshillit të Ministrave që në kategoritë e veçanta të personave që trajtohen me përfitime (*pensioneve suplementare*) të ketë një politikë trajtimi të qëndrueshme dhe të mirë studiuar, duke ndikuar në mbajtjen nën kontroll të këtyre shpenzimeve (*përfitimeve*) në të ardhmen afatmesme dhe afatgjatë.

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

I. Për sistemin e sigurimit shoqëror

Në kategorinë e shpenzimet për pensione të veçanta hyjnë edhe shpenzimet për pensionet sociale të cilat janë realizuar në shumën 99.6 milion lekë dhe paraqiten me realizim në masën 82.4 % ose janë shpenzuar më pak 21 milion lekë. Kjo skemë pensioni është e vendosur për here të parë në këtë vit, nga zbatimi reformës së sigurimeve shoqërore. Kështu, sipas planit të buxhetit ishin planifikuar për përfitim të këtij pensioni 5,000 persona me shumë totale 119.6 milion lekë, në fakt kanë përfituar 1.811 pensioniste me vlerë 79.5 milion lekë. Gjatë vitit 2015 u paraqitën 2.031 kërkesa për pension social, nga të cilat janë caktuar vetëm 1.811 pensione. Pra, kursimi i këtyre shpenzimeve me 40.1 milion lekë, ka ardhur nga mosrealizimi i numrit të përfituesve, për shkak të mos plotësimit të kriterëve sepse shumë nga personat që janë planifikuar për përfitim të cilët nuk kanë pasur periudhë kontributive, janë trajtuar gjatë vitit me pensione familjare *trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH në çdo vit buxhetor numrin e personave që përfitojnë pensione sociale dhe shpenzimet për këto pensione, ti planifikoj në bazë të numrit faktike të personave dhe shpenzimeve faktike të vitit të mëparshëm.

Në vijimësi

Mbajtja e fondit rezervë të sigurimeve shoqërore është detyrim që buron nga neni 70, i ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” në të cilin përcaktohet se, normativa e fondit rezervë duhet të jetë sa të mbulojë një muaj shpenzimet për pensione. Në fund të vitit 2014, gjendja e fondit rezervë ishte 4,009,812,700 lekë. Në vitin 2015 me Vendim të KA është bërë sistemimi rezultatit financiar të vitit 2014 duke e shtuar fondin rezerve me 640,708,842.96 lekë. Fondi rezervë për vitin 2015 arriti në shumën 4,650,521,543 lekë. Sipas bilancit financiar të vitit 2015 fondi rezervë duhet të ishte 7,1726 milion lekë, pra është më pak me diferencë prej 2,522 milion lekë dhe ky fond i akumuluar nuk mbulon shpenzimet e një muaji. Kjo mungesë ka ardhur pasi, KM me ligj të veçantë nga rezultati financiar i vitit 2014 tërhoqi nga buxheti i ISSH 6,000 milionë lekë për llogari të buxhetit të shtetit, *trajtuar më hollësisht në faqen _____, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Meqenqë aktiviteti financiar i ISSH për vitin 2015 ka dalë me rezultat pozitiv, fitimi i krijuar duhet të shkojë për plotësimin e fondit rezerve në normativën e përcaktuar në ligjin e sipërcituar, dhe diferenca më tepër të shkojë për politikat e pensione.

Në vijimësi

II. Aktiviteti administrativ i ISSH:

1. Nga auditimi i dosjeve për mbledhjet e Këshillit Administrativ u konstatua se në të gjitha Proces Verbalet ka parregullsi në nënshkrimin e tyre nga ana e anëtarëve të Këshillit. Nga rishikimi i procesverbaleve, u konstatuan raste kur mbledhja është mbajtur me më pak anëtarë, në kundërshtim me VKM nr. 161 datë 11.04.1994 “Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shëndetësore” neni 18 “Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të punëdhënësve dhe të sindikatave si anëtarë të këshillit administrativ. Vendimet merren me shumicë votash”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH të marrë masa të hartojë në mënyrë të saktë dhe të plotë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Administrativ me të gjithë elementët përbërës të tij, për të lënë gjurmë mbi numrin e pjesëmarrësve në mbledhje. Gjithashtu, të sigurohet se plotësohet numri i duhur i anëtarëve për mbarëvajtjen e mbledhjes së KA, në përputhje me VKM nr. 161, dt. 11.04.1994.

Në vijimësi

2. Nga auditimi i zbatimit të buxhetit të brendshëm të institucionit konstatojmë se, deri në fund të vitit janë kryer shpenzime sipas zërave përkatës, të cilat nuk kanë qenë të mbuluar totalisht me fonde, por për to është bërë ndryshimi i tyre në muajin dhjetor, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 dhe Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH, të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të ndryshimeve në zërat e buxhetit në fund të vitit dhe zbatimi i buxhetit të bëhet në përputhje me kërkesat e Udhëzimeve të Ministrit të Financave për zbatimin e buxheteve vjetore.

Në vijimësi

3. Nga arka në lekë, në 11 raste janë kryer shpenzime për blerje “emergjencash” dhe blerjeve në kuotën “nën 100,000 lekë”, të cilat nuk janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës (procesverbale të personave të pranishëm të ndodhjes së ngjarjes në rastet e emergjencave dhe procesverbalin e komisionit të blerjeve me vlera të vogla sipas formateve të miratuara) në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël”. Në 4 raste nëpërmjet bankës është likuiduar shuma totale prej 210,956 lekë pa

zhvilluar procedura prokurimi për blerje me vlera të vogla për blerje mallra, pune apo shërbime, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të Udhëzimit APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”. Në disa raste të tjera, marrja në dorëzim e mallrave nuk është bërë konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 57, datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde të auditimit në prokurimet....”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH, të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla dhe të veprohet konform kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të Udhëzimit APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, si dhe marrja në dorëzim e mallrave të bëhet sipas kërkesave të dispozitave ligjore.

Në vijimësi

4. Nuk është zbatuar VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011”, pasi nuk përdorej dokumenti i urdhër shërbimit, por në vend të këtij dokumenti janë plotësuar deklarata për shpenzime udhëtimi jashtë shtetit. Kjo deklaratë në të gjitha rastet nuk është plotësuar personale, por plotësohej në grup, po kështu dhe mandat pagesat nuk plotësohen personale, por për njërin prej anëtarëve të këtij grupi nënshkruante për mbylljen e dietave për llogari të grupit. Gjithashtu të gjitha këto deklarata nuk ishin nënshkruar nga nëpunësi zbatues si dhe nëpunësi autorizues, për të lënë gjurmë mbi mënyrën e llogaritjeve të dietave për çdo shërbim jashtë vendit. Po kështu në praktikën e shërbimeve jashtë shtetit nuk ka të lidhura ftesat e ndryshme të shteteve të huaja, siç përcakton edhe VKM nr. 870, datë 14.12.2011 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH, të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla dhe të veprohet konform kërkesave të VKM nr. 870, datë 14.12.2011, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, ku për çdo shërbim jashtë shtetit, të gjitha praktikave të urdhërshërbimeve ti bashkëlidhen ftesat e palës pritëse.

Në vijimësi

5. Janë llogaritur e paguar gabim biletat e shërbimeve të punonjësve që kanë shkuar me shërbim brenda vendit jashtë qendrës së punës, konstatim dhe detyrë e lënë dhe nga auditimet e mëparshme. Nuk ka gjetur zbatim të plotë urdhri i ministrit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr. 125, datë 26.12.2011, pasi nuk janë pasur parasysh distancat e miratuara nga ky urdhër si dhe nuk janë bërë llogaritjet konformë tarifave të transportit të miratuara me VKM nr. 666, datë 7.02.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr. 146, datë 26.2.1998 “për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të paraqitura në aneksin nr. 1, pasqyra nr. 1 “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancave kilometrike”. Konstatohet se në rastin e pagesës së punonjësit të IT, të marrë me kontratë nuk ka dokumentacion që të justifikojë punën e kryer, si listëprezencë apo raporte pune. Gjithashtu, në pagesat me bankë vërehen raste të korrigjimeve të dokumenteve justifikuese, kryesisht të listëprezencave të anëtarëve të K.M.C.A.P Epror, në të gjithë periudhën e auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH, të marrë masa që në të ardhmen të kryhen pagesat mbështetur vetëm në dokumentacionin e saktë justifikues. Për pagesat e shpenzimeve të transportit të punonjësve të llogariten saktë e konformë kërkesave të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 dhe urdhrin të ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 125, datë 26.12.2011.

Në vijimësi

6. Autoriteti Kontraktor (ISSH), ka anuluar procedurën e prokurimit “Për prodhimin dhe pajisjen e personave të siguruar me librezë të kontributeve të sigurimit shoqëror e shëndetësor” me fond limit 40 milion lekë të zhvilluar në datën 11.05.2015 në kundërshtim me nenin 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, sepse ka s’kualifikuar nga kjo procedurë të 7 operatorët pjesëmarrës. Në veçanti ka s’kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] i cili përmbushte të gjitha kërkesat ligjore dhe kualifikuese dhe duhej kualifikuar dhe shpallë fitues për ofertën më të ulët në vlerën 20,640,000 lekë. Si pasojë e anulimit, kjo procedurë është ri shpallur përsëri dhe është zhvilluar në datën 31.08.2015. Në këtë procedurë fituesi ka paraqitur ofertën ekonomik më të lartë për 14,712,000 lekë se BOE [REDAKTUAR] i s’kualifikuar nga procedura e anuluar. Nga këto veprime apo mosveprime të AK, nuk janë respektuar rregullat e prokurimit publik në lidhje me efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit si dhe janë përdorur fonde pa efektivitet dhe ekonomikitet.

Për sa më sipër rekomandojmë:

a. ISSH, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për çdo procedurë prokurimi që anulohet për shkak të mungesës së konkurrencës, para se të rishpallet procedura edhe një herë, duhet të analizojë shkaqet që dështuan procedurën e parë, të nxjerri përgjegjësitë përkatëse dhe të korrigjojë dokumentet e tenderit të procedurës që do të rihapet.

b. ISSH, të marrë masa, të analizojë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike në vlerën 14,712,000 lekë.

Në vijimësi

7. Nga auditimi i regjistrimeve dhe llogaritjeve të raporteve shëndetësore të dorëzuara nga ana e punonjësve, rezultoi se ka parregullsi në trajtimin e tyre. U konstatuan raste kur Sektori i Financës ka llogaritur më shumë ditë pune për punonjës të cilët kanë munguar, me dokument justifikues raportin mjekësor. Problematika ka edhe në hartimin e listëprezencave, ku rezultojnë mosrakordime midis ditëve të punës dhe raporteve të dorëzuara.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Sektori i Financës të zbatojë me korrektësi procedurat për pagesën e punonjësve sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, si dhe të kryhet regjistrimi i saktë midis ditëve punë dhe ditëve raport në listëprezencë.

Në vijimësi

8. Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të ISSH-së, të hartuara nga Nëpunësi Zbatues dhe aprovuara nga Nëpunësi Autorizues konstatuam se këto pasqyra janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit dhe Ministrisë së Financës me shkresën nr. 2782 datë 31.03.2016. Gjithashtu rezultoi se, ISSH ka ridorëzuar Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2015 pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr. 4698 datë 30.05.2016, në të cilat janë pasqyruar ndryshimet e fundit (shitesa) në të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për llogari të ISSH-së për vitin ushtrimor 2015. Në përfundim, konkludojmë se Pasqyrat Financiare të vitit 2015 të ISSH-së, kanë dhënë një pamje jo plotësisht të saktë për sa i takon nivelit të të ardhurave të evidentuara në këto pasqyra. Fakti që pasqyrat reflektojnë ngjarje pas datës së bilancit në mënyrë jo korrekte referuar standardeve të kontabilitetit publik, ngrenë problemin e mos njohjes si duhet të rregullohet të raportimit financiar.

Edhe në pasqyrat vjetore të 2015, vijon mbartja e problematikës së mosrakordimit të detyrimeve ndërmjet ISSH dhe Ministrisë së Financave. Konstatuam se Llogaria 44-Institucione të tjera publike paraqitet me vlerën 344,936 mijë lekë, kjo llogari përfaqëson kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të derdhura në Depozitën e Qeverisë (TSA), por të pa derdhura këto në llogarinë e ISSH-së në fund të vitit. Nga auditimi u konstatua se, vlera 284,686 mijë lekë e mbartur që nga viti 2011 dhe 2012 në bilancin e

Drejtorisë së Buxhetit të Përgjithshëm të ISSH-së, nuk konfirmohet nga Ministria e Financave, fakt që rezulton nga korrespondenca e vazhdueshme e dy institucioneve, problematikë kjo e trashëguar dhe trajtuar më gjerësisht nga vitet e mëparshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

ISSH, në të ardhmen, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Ministrinë e Financave, të marrë të gjitha masat në mënyrë që në Bilancin Financiar të ISSH, të ardhurat nga DPT të transmetohen në kohë reale në mënyrë që pasqyrat financiare të realizojnë objektivin e tyre si dhe të garantojnë përdoruesit që informacioni është i saktë.

Menjëherë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ti kërkojë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, të kontrollojë transaksionet financiare për të konfirmuar detyrimin prej 284,686 mijë lekë të mbartur që nga viti 2011 dhe 2012 në bilancin e ISSH-së, për të cilin përgjegjësia institucionale nuk dihet.

Menjëherë

9. Nga auditimi i Auditimit të Brendshëm si një element i rëndësishëm për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, konstatuam se Institucioni ka të organizuar këtë funksion në nivel Drejtorie në ndihmë të linjës së menaxhimit. Gjatë vitit 2015, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm janë realizuar 55 auditime nga 50 të planifikuara. Auditimet janë realizuar sipas planit vjetor të auditimit duke i dhënë përparësi subjekteve me risk të lartë.

a. Nga auditimi i Raporteve Finale në DRSSH, rezulton se në auditimet tematike të kryera me objekt *“Auditimi i regjistrimit të të dhënave të përfituesve në regjistrin elektronik të përfitimeve, evidentimi i rasteve të konstatuara me ndryshim datëlindje, dublim të periudhave të sigurimit etj” janë konstatuar 719 gjetje duke krijuar një dëm financiar për 837,042 mijë lekë.*

b. Komisioni AD-HOC merret me rastet kur në sistemin e Sigurimeve Shoqërore rezultojnë me përfitime të paligjshme *(raste përfitimesh me më shumë se një pension nga i njëjti përfitues)*. Konstatuam se të gjitha këto raste i nënshtrohen një auditimi të plotë duke nxjerrë përgjegjësitë për përfituesit si dhe për të gjitha rastet bëhet kallëzim penal të cilët kanë paraqitur dokumente të parregullta dhe kanë përfituar 2 përfitime nëpërmjet mashtrimit. Dëmi financiar i konstatuar nga ky komision për vitin 2015 është në masën 100,879 mijë lekë ku janë evidentuar 98 raste.

c. Nga auditimi financiar, bazuar në rezultatet e angazhimeve të auditimeve të evaduar për vitin 2015 janë konstatuar 131 gjetje në degën e auditimit financiar dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik me vlerë 4,212 mijë lekë.

Në lidhje me sigurimin e cilësisë dhe të bazës ligjore, konstatuam se në përgjithësi programet e auditimit janë të plota, por konstatohet përsëri problematika e vonës në evadimin e materialeve të auditimit.

Në funksion të rekomandimeve të lëna nga KLSH, konstatuam se ka filluar raportimi i kësaj njësie sipas kërkesave rregullative, kështu në shtator të vitit 2015, Drejtoria e Auditit të Brendshëm e ISSH, ka raportuar pranë N/Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me *“Raportin e auditimit mbi rezultatin financiar dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare të ISSH-së për vitin 2014”* si dhe *“Raportimin mbi aktivitetin e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2014 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2015”*.

Me Urdhrin nr. 8576 datë 30.10.2015 të Drejtores së Përgjithshme znj. **V B**, është liruar nga detyra si Drejtor i Drejtorisë Auditimit të Brendshëm Z. **A B** dhe ka kaluar në pozicionin e Kryetarit të Degës së Auditimit Ekonomik Financiar pranë DAB në ISSH. Kalimi në pozicionin e Kryetarit të Degës së Auditimit Ekonomik Financiar, pa konfirmimin e Këshillit Administrativ si dhe lënia e përgjegjësisë për realizimin e të gjitha funksioneve nga i njëjti person, krijon një ekspozim operacional në realizimin e këtij funksioni të rëndësishëm për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Aktualisht pozicioni i Drejtorit të Auditit të Brendshëm të ISSH-së, rezulton akoma vakant.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Administrativ i ISSH, të merret në shqyrtim dhe të përcaktohet statusi i z. **A B**, bazuar në një vlerësim të kujdesshëm të kriterëve duke eliminuar risqet operationale të konstatuara gjatë veprimtarisë së fundvitit 2015.

Menjëherë

C. TË TJERA

Ky Vendim do të përcillet i plotë, pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Punës dhe Ministrisë së Financave me qëllim sensibilizimin e këtyre aktorëve kryesorë në mbajtjen nën kontroll të qëndrueshmërisë financiare të skemës së pensioneve, sinergjizimin e energjive në drejtim të ndërhyrjeve të shpejta në rast të reflektimit të impakteve negative nga vendimmarrjet e mundshme si dhe bashkëpunimit të të gjithë faktorëve dhe aktorëve për të mundësuar incentiva të rinj në drejtim të shëndoshjen së skemës aktuale, kjo përmes sjelljes së praktikave më të mira ndërkombëtare kombinuar me mjedisin e vështirë shqiptar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

KRYETAR